



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

PA1.nr.1001/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm - në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Kadrije Goga Lubishtani – kryetare e kolegjit, Zyhdi Haziri dhe Beqir Kalludra - anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Jeton Leci, në çështjen penale ndaj të akuzuarës R.D. nga Gjilani, për shkak të veprës penale, Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par 8 lidhur me par 6 dhe 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke vendosur përkitazi sipas ankesës së Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, si dhe përgjigjen në ankesë së të akuzuarës të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.559/21 datë 05.10.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18.04.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Prokurorit Themelor në Gjilan, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.559/21 datë 05.10.2021 **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin P.nr.559/21 datë 05.10.2021, të akuzuarën R.D. për veprën penale, Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par 8 lidhur me par 6 dhe 1 të KPRK-së, e ka shpallur fajtor dhe gjykuar, me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3(tre) muaj, i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarës, në kuptim të nenit 44 të KPRK-së, i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumën prej 1000 (njëmijë) Euro, të cilin dënim

është i obliguar ta paguaj pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën ka për ta vuajtur dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3(tre) muaj. I dëmtuari E. R. H. nga fshati ..., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil. E akuzuara obligohet që në emër të paushallit gjyqësor ta paguaj shumën prej 20 (njëzetë) Eurove, si dhe shpenzimet e procedurës sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka ushtruar

Prokurori Themelor në Gjilan, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, nga neni 383 par 1 nënpar 1.4 lidhur me nenin 387 par 1 të KPP-së duke propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës, ankesën ta aprovoj, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj, ashtu që të akuzuarës ti shqiptoj dënim me burgim efektiv më të lartë, në mënyrë që sanksioni i shqiptuar penal të jetë proporcional me peshën e veprës penale, pasojat e shkaktuara me veprën e kryer si dhe përgjegjshmërinë dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale.

Ndaj ankesës së Prokurorisë përgjigje në ankesë ka parashtruar e akuzuara me propozim që Gjykata e Apelit ankesën e Prokurorisë Themelore ta refuzoi si të pa bazuar ndërsa aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan P.nr.559/2021 datë 05.10.2021 ta vërtetoi.

Prokurori i Apelit në Prishtinë me parashtrësën PPA/II.nr.1039/22, datë 20.05.2022, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore, të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar dhe ndaj të akuzuarës të shqiptohet një dënim me burgim më i lartë.

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoj aktgjykimin e kundërshtuar në kuptim të nenit 394 të KPP, dhe pas vlerësimit të pretendimeve në ankesë gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës se nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarës, e të cilat do kishin kushtëzuar anulimin e tij.

Po ashtu, as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse e akuzuara e ka pranuar fajësinë e kjo vërtetohet edhe nga deklarata e saj në seancën e shqyrtimit fillestar të datës 05.10.2021 e cila ka deklaruar se e pranon fajësinë për kryerjen e kësaj veprë penale, prandaj sipas nenit 383 par. 2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë, nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve.

Për këtë arsye, aktgjykimi i ankimuar, u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore, lidhur me vendimin mbi dënimin.

Prokurori e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke pretenduar që gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së aktgjykimit, në mënyrë të drejtë, të plotë e të qartë ka vërtetuar gjendjen faktike se e akuzuara ka kryer veprën penale në fjalë, ashtu si ajo është përshkruar në dispozitiv të akuzës. Mirëpo, edhe për kundër faktit se gjykata këtë çështje penalo juridike e ka gjykuar drejt dhe mbi bazën e fakteve të argumentuara në seancë për shqyrtim gjyqësorë, por konsideron se gjykata nuk i ka shqiptuar të akuzuarës dënim të merituar sipas ligjit sepse në këtë rast kemi të bëjë me aksident komunikacioni, ku është goditur dhe lënduar biçiklisti E.H., kështu që këtë dënim e zbuti deri në atë masë e cila bie në kundërshtim me rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit nga nenet 70, 71 e 72 të KPRK-së. Rrethanat lehtësuese çfarëdo çofshin ato assesi në rastin konkret nuk kanë guxuar të vlerësohen se janë të asaj rëndësie që të ndikonin që dënimin e parashikuar ligjorë për këtë veprë penale të zbutet gjer në këtë nivel, që të akuzuarit ti shqiptohet një dënim i tillë. Në rastin konkret, të gjitha rrethanat lehtësuese të potencuara me rastin e caktimit të dënimit ndaj të akuzuarës, nuk e kanë atë rëndësi që dënimi të zbutët gjer në këtë masë në njërin anë, ndërsa në anën tjetër nuk është përmendë asnjë rrethanë veçanërisht lehtësuese e që deri diku do ta arsyetonte sanksionin e shqiptuar penal për të akuzuarën. Po ashtu vlen të theksohet se gjykata me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e dënimit nuk ka përmendë asnjë rrethanë rënduese, duke mos i kushtuar kujdes rrethanave tjera si; pasoja që i është shkaktuar të dëmtuarit, lëndimet trupore, shqetësimet, se aksidenti është shkaktuar me lëshimet primare të akuzuarës e që veprimet e tilla kanë qenë të rrezikshme për pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion, po të vlerësoheshin këto rrethana në mënyrën e duhur, sigurisht se sanksioni penal do të ishte tjetër dhe më i ashpër, sepse dënimi i shqiptuar për këtë veprë penale është minimal, andaj nga të cekurat propozon si më lartë.

Gjykata e Apelit në Prishtinë vlerëson se pretendimet ankimore të prokurorisë, që të akuzuarës ti shqiptohet një dënim me burgim efektiv më të lartë nuk janë të bazuara. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në përgjithësi drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa në ankesën e lartcekur nuk është paraqitur ndonjë rrethanë e rëndësishme dhe e posaçme që nuk është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë, e cila do ta arsyetonte shqiptimin e një dënimi më të lartë ndaj të akuzuarës. Kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Kështu gjykata si rrethanë lehtësuese mori faktin se e akuzuara ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, qëndrimin e saj korrekt në gjykatë, është pajtuar me palën e dëmtuar, se bashkëshorti i saj rregullisht e ka vizituar të dëmtuarin në spital dhe është penduar për veprën e kryer, ndërsa rrethana rënduese nuk ka gjetur me bindjen se dënimi i shqiptuar do ndikoj në arritjen e qëllimit të dënimit nga neni 38 të KPRK-së, dhe se dënimi i shqiptuar është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të të akuzuarës. Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa pretendimet në të cilat thirret prokurori, nuk janë të atij karakteri dhe nuk kanë ndikim që të akuzuarës ti shqiptohet një dënim tjetër nga ai të cilin e ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë apo që të akuzuarës t'i shqiptohet dënim me burgim efektiv më të lartë sikurse që pretendohet në ankesë. Të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, andaj duke marrë parasysh rrethanat e konstatuara dhe drejtë të vlerësuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, del se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarës është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer, me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarës si ekzekutor dhe se kjo do t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me këtë kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të bëhet rehabilitimi i tij. Andaj kolegji penal i kësaj gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar është i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

Departamenti i Përgjithshëm

PA1.nr.1001/2022, më datë 18.04.2023

B. Profesional

Jeton Ieci

Anëtarët e kolegjit:

Zyhdi Haziri

Beqir Kalludra

Kryetare e kolegjit,

Kadrije Goga Lubishtani
